



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPIJAN

Në bazë të nenit 12 dhe 61 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 5,6,7, 8 dhe 9 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.03/2023 për procedurën e emërimit të nënkryetarëve në Komuna si dhe nenit 20 par. 20.1 dhe 44 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i dates 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 24.03.2026 pas shqyrtimit të propozim Vendimit mori këtë:

## V E N D I M PËR EMËRIMIN E NËNKRYETARES SË KOMUNËS PËR KOMUNITETE

### Neni 1 Emërimi

**MEHREME GOLIQI** nga Hallaqi i Vogël me përgaditje universitare nga komuniteti jo shumicë ashkali, **emërohet** Nënkyetare e Komunës për Komunitete në Komunën e Lipjanit.

### Neni 2 Përgjegjësitë e Nënkyetares së Komunës për Komunitete

1. Nënkyetaria e komunës për komunitete e ndihmon kryetarin e komunës në kryerjen e detyrave të tij, duke ofruar këshilla dhe udhëzime lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet jo shumicë.
2. Mbështet dhe afirmon kërkesat e komuniteteve jo shumicë në organet e komunës, përfshirë edhe raporte të rregullta për kryetarin e komunës mbi këto kërkesa.
3. Në konsultim me kryetarin, siguron që nevojat dhe interesat e komuniteteve jo shumicë merren në konsideratë gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit të komunës.
4. Merr pjesë në takimet e kuvendit të komunës.

### Neni 3 Mandati

Mandati i Nënkyetarit të Komunës për Komunitete është i njëjtë me atë Kryetarit të Komunës.

### Neni 4 Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit faqen elektronike të Komunës.

Nr. 15-112/02-13723  
Lipjan, më 24.03.2026

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN



Kryesuesi i Kuvendit  
Daut Azemi